

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT  
 DHE SPORTIT  
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

## MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2025

### KUALIFIKIMI PROFESIONAL "SHËRBIME KUJDESI PËR TË MOSHUAR"

#### Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11	12	13	14	15	16
Pikët								
Kërkesa	17	18	19	20	21	22	23	24
Pikët								
Kërkesa	25	26	27	28	29	30		
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Mbledhja e të dhënave është etapa e parë e kujdeseve infermierore. Metoda e vëzhgimit direkt të pacientit, pa ndihmën e mjeteve të tjera por vetëm me organet e ndjeshmërisë quhet: **1 pikë**
- A) Observim
  - B) Palpacion
  - C) Auskultacion
  - D) Intervenim
2. Kujdesi infermieror realizohet në disa faza. Shkrimi i planit të kujdesit është aktivitet që realizohet në fazën e: **1 pikë**
- A) Mbledhjes së të dhënave
  - B) Planifikimit të ndërhyrjeve
  - C) Realizimit të ndërhyrjeve
  - D) Verifikimit të efikasitetit
3. Ka shumë faktorë të jashtëm dhe të brendshëm që influencojnë në shëndet dhe praktikat shëndetësore të një pacienti. Në faktorët e brendshëm futen: **1 pikë**
- A) Praktikrat familjare
  - B) Stadet e zhvillimit të një personi
  - C) Faktorët social-ekonomik
  - D) Biografia kulturore
4. Shumica e infeksioneve të traktit urinar tek të sëmurët e hospitalizuar vjen për shkak të: **1 pikë**
- A) Infeksioneve të përgjithshme
  - B) Infeksioneve nozokomiale
  - C) Përdorimit të pajisjeve drenuese të urinës
  - D) Inkontinencës urinare
5. Sterilizimi është procesi i eliminimit të mikrobeve në masën 100%, i cili realizohet në katër faza. Në fazën e parë ndodh: **1 pikë**
- A) Paketimi
  - B) Sterilizimi
  - C) Dekontaminimi
  - D) Deponimi
6. Farmakologjia është shkenca që studion farmakokinetikën dhe farmakodinamikën. Farmakodinamika përfshin: **1 pikë**
- A) Mekanizmin e veprimit të barnave
  - B) Biotransformimin e barnave
  - C) Ekskretimin e barnave
  - D) Shpërndarjen e barnave

7. Cila nga rrugët e mëposhtme përfshin rrugën natyrale për marrjen e barnave? **1 pikë**
- A) Intravaskulare
  - B) Intramuskulare
  - C) Intrakavitare
  - D) Enterale
8. Mënyra e ekskretimit që ka rëndësi për eliminimin e anestetikëve të përgjithshëm të gaztë është: **1 pikë**
- A) Ekskretimi me veshka
  - B) Ekskretimi me pulmone
  - C) Ekskretimi me rrugë biliare
  - D) Ekskretimi me pështymë
9. Cili nga medikamentët e mëposhtëm përdoret më tepër në pagjumësitë e fëmijëve? **1 pikë**
- A) Prometazina
  - B) Zolpidem
  - C) Zopiklon
  - D) Phenobarbitali
10. Medikamenti kardiotonik që lidhet 95% me proteinat plazmatike është: **1 pikë**
- A) Digoksina
  - B) Adrenalina
  - C) Digitoksina
  - D) Dopamina
11. Struktura bazë e cipës qelizore ndërtohet nga: **1 pikë**
- A) Lipidet
  - B) Karbohidratet
  - C) Proteinat
  - D) Glikoproteinat
12. Organet me rëndësi jetike për qelizën, që marrin pjesë në frymëmarrjen qelizore si dhe në prodhimin e energjisë, janë: **1 pikë**
- A) Lizozomet
  - B) Mitokondret
  - C) Aparati i Golxhit
  - D) Mikrotubulat

13. Sipas origjinës së muskujve apo përfundimit të tyre në kockë, ato mund të jenë të thjeshtë apo të shumënumërta. Kur fillimi është me dy kokë, muskuli quhet: **1 pikë**
- A) Triceps
  - B) Quadriceps
  - C) Pluricaudat
  - D) Biceps
14. Ngjarjet elektrike dhe mekanike të ciklit kardiak ndodhin në pesë faza. Gjatë fazës së tretë ndodh: **1 pikë**
- A) Mbushja pasive
  - B) Kontraksioni atrial
  - C) Eksitacioni ventrikular
  - D) Ejeksioni
15. Cila nga pjesët e strukturës funksionale të indit nervor nuk ka funksion përcjellës: **1 pikë**
- A) Neuroglia
  - B) Aksoni
  - C) Neuroni
  - D) Lidhjet neuronale
16. Hipertensioni arterial është shtimi mbi normë i presionit të gjakut. Hipertensioni parësor (esencial) është pasojë e: **1 pikë**
- A) Glomerulonefritit
  - B) Çrregullimit të debitit kardiak
  - C) Nefropatisë
  - D) Sëmundjeve të gjëndres tiroide
17. Sëmundja ulçeroze gastroduodenale karakterizohet nga dëmtimi i mukozës së stomakut dhe duodenit në formën e ulçeracioneve. Shkaku më i shpeshtë i sëmundjes është: **1 pikë**
- A) Përdorimi duhanit
  - B) Përdorimi i alkolit
  - C) Ngrënia e ushqimeve pikante
  - D) Helicobakter pilori
18. Anuria është term që përdoret për të pëshkruar: **1 pikë**
- A) Urinimin në sasi të mëdha
  - B) Pakësimin e urinimit
  - C) Pamundësinë për të urinuar
  - D) Praninë e gjakut në urinë

19. Hipofiza është një gjëndër e vogël që ndodhet në tru, poshtë hipotalamusit. Përbëhet nga lobi i përparmë dhe lobi i pasmë. Në lobin e pasmë prodhohet: **1 pikë**

- A) Hormoni somatotrop
- B) Hormoni antidiuretik
- C) Hormoni adrenokortikotrop
- D) Hormonet gonadotrope

20. Vështirësia respiratore që kërkon sforcim nga ana e pacientit quhet: **1 pikë**

- A) Dispne
- B) Stridor
- C) Apne
- D) Ortopne

21. Listoni më poshtë katër nga etapat e procesit të kujdesit infermieror: **4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

22. Shërbimi i stelilizimit duhet të udhëhiqet nga një person i kualifikuar. Një element shumë i rëndësishëm është uniforma e personit që kryen sterilizimin. Listoni më poshtë katër elementët e domosdoshëm në uniformë: **4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

23. Bronkodilatatorët janë preparate që veprojnë duke larguar bronkospazmat. Sipas mekanizmit të veprimit ndahen në katër grupe. Listoni më poshtë cilat janë këto grupe: **4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

24. Benzodiazepinat janë medikamente sedativo-gjumëdhënëse. Bazuar në kohëzgjatjen e efektit benzodiazepinat ndahen në katër grupe. Listoni më poshtë cilat janë këto grupe: **4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

25. Listoni më poshtë cilat janë katër funksionet komplekse që kryen sistemi tretës; **4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

26. Stomaku është segmenti më i gjerë i tubit digjestiv. Dallojmë katër forma të stomakut. Listoni më poshtë cilat janë ato: **4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

27. Mitokondret janë organele të qelizës me strukturë vezake ose sferike. Nga ana funksionale mitokondret janë organele me rëndësi jetike për qelizën. Listoni më poshtë katër nga këto funksione: **4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

28. Me aritmi kuptohet çrregullimi i ritmit normal dhe frekuencës së rrahjeve normale të zemrës. Çrregullimet e ritmit të zemrës grupohen në pesë grupe. Listoni më poshtë katër prej tyre: **4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

29. Insuficienca renale akute nënkupton uljen e menjëhershme, të pjesshme deri edhe të plotë të funksionit të veshkave. Listoni më poshtë katër nga shkaqet e IRA-së: **4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

30. Sistemi respirator ka katër përbërës, ku secili duhet të funksionojë si një sistem për të ruajtur homeostazën. Listoni më poshtë këta përbërës: **4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

